

VENDIM
Nr. 308, datë 11.5.2022

PËR CAKTIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL SI ORGAN PËRGJEGJËS PËR REALIZIMIN E PROCEDURËS SË DERATIZIMIT TË BIMËS SË GËSHTENJËS, ME QËLLIM MBROJTJEN E SAJ NGA PARAZITI GRERËZA GALEFORMUESE (*DRYOCOSMUS KURIPHILUS HYMENOPTERA: CYNIPIDAE*)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar; të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, dhe të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organ përgjegjës për realizimin e procedurës së deratizimit të bimës së gështenjës, me qëllim mbrojtjen e saj nga paraziti grerëza galeformuese (*Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae*).

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ngarkohet për kryerjen e prokurimit dhe lidhjen e kontratës për kryerjen e shërbimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, si dhe monitorimin e zbatimit të kontratës.

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore/bashkitë, të monitorojnë respektimin e kërkesave teknike trajtuese, të vendosura në zbatim të këtij procesi.

4. Fondi për procedurën e prokurimit publik të përballohet nga buxheti i miratuar, për vitin 2022, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpenzimet korrente në programin buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, produkti “Sipërfaqe e trajtuar dhe e mbrojtur nga parazitët në fushën e bujqësisë”.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore/bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama